



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKI SHIJAK
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT -VENDIM

“PER DETAJIM NGA FONDI I KONTIGJENCES PER VITIN 2021 “

Duke u mbështetur ne Ligjin 68 date 24/04/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, ne Ligjin nr 57/2016 te ndryshuar Ligjin 9936, datë 26.06.2008 “Për disa shtesa ne menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” Vendimin Keshilli Bashkiak Nr 123 date 24.12.2020“ Mbi Buxhetine vitit 2021 “, ne Ligjin nr 137 /2020 “ Per Buxhetin e Shtetit te Vitit 2021.”,ne Udhezimin nr 9 te Ministrise se Financave date 20/03/2018 “Per Procedurat Standarte te Zbatimi te Buxhetit “,dhe te Udhezimit plotesues te Ministrise se Financave nr 4 date 24/01/2021 “ Per Zbatimin e Buxhetit te vitit 2021 , ne mbështetje te Akt-Marrveshjes se lidhur per depozitimn e Mbetjeve ‘ ne Land fillin e Sharres, jemi ne kushtet e perdorimit te fondit te kontigjences per mbulimin e shpenzimeve te tarifes hyrese ne landfill per kuoten 29 euro pa tvsh per ton mbeturina, deri ne momentin e clirimit te fondeve nga Buxheti Qendror per mbështetjen financiare te premtuar me VKM nr 438 date 15.07.2021 per kete qellim ne baze te kerkeses qe eshte paraqitur ne Ministrine e Financave .

Nga perlloraritjet e bera na nevojiten te detajojme nga fondi i kontigjences nje shume per perballimin e ketij shpenzimi qe shkon ne 3,438,936 leke ne muaj.Per ti paraprire cdo situatë mendojme te planifikojme shpenzime per 2 muaj ,dhe ne momentin qe fondet buxheore behen active ne Buxhetin e Bashkise , ne fillojme perdorimin e tyre .

Fondi I kontigjences qe perdoret per te tilla raste ne Buxetin e vitit 2021 te miratuar me VKB nr 123 date 24.12.2020 eshte 12.642.000 ,I cili do te pakesohet per shumen 6.877.872 leke.

Keshtu fondi I kontigjences mbetet ne shumen 5.764.128 leke

Juristi


Xhupana Keci

Sekretarja e Keshillit Bashkise

Kozeta Doda

Kryetari

Elton Arbana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA EKONOMIKE

Shijak, më 06.08.2021

PROJEKT - VENDIM

“Për miratimin e akt-marrëveshjes për depozitim mbetjesh pranë Zonës së Trajtimit të Mbetjeve Tiranë”

Në mbështetje të nenit 9 , pika 1.3, gërma “ ç”, nenit 10, nenit 22 , pika 2 dhe pika 3, nenit 23 , pika 10, nenit 32, 33 dhe nenit 64, pika “gj” të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 26, 28 pika 1 germa “b” të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.10463 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 967, datë 25.10.2013, “Për mënyrën e organizimit e funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.418, datë 27.05.2020 “ Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 27.06.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në Nr.452, datë 11.07.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”, paraqes relacionin shpjegues “Për miratimin e akt-marrëveshjes për depozitim mbetjesh pranë Zonës së Trajtimit të Mbetjeve Tiranë”.

Bashkia Shijak, si çdo njësi e qeverisjes vendore është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të pastrimit, mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, përgjegjësi e përcaktuar në ligjin organik nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 23.

Bashkia Shijak e ofron shërbimin e pastrimit, mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve nëpërmjet sipërmarrjes private të kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike. Mbetjet e gjeneruara brenda territorit administrativ të bashkisë Shijak, depozitoheshin në VGM-në e Porto-Romanos Durrës, në bazë të një akt-marrëveshje me Bashkinë Durrës.

Me shkresën me nr.1286 prot. datë 29.05.2020 të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës Publike na është bërë me dije mbyllja e vend depozitimit të mbetjeve në Porto-Romano për shkak të vënies në zbatim të projektit për kapsulimin e

mbetjeve dhe rijetësimin e zonës në EkoPark, sipas Vendimit nr.1 datë 16.01.2010 të Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Aktualisht dhe me referencë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.38 datë 14.06.2021 Për miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në vendimin nr.6 datë 20.05.2021 të Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Vendimin nr.3 datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës” e vetmja mundësi zgjidhje është depozitimi i mbetjeve në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë ose siç njihet ndryshe në landfillin e Sharrës. Bashkia Shijak ka qenë në negociata të vazhdueshme me shoqërinë konçesionare Integrated Energy BV SPV sh.p.k me qëllim depozitimin e mbetjeve në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë (Z.T.M.T), negociata të cilat janë finalizuar me sukses dhe aktualisht jemi në prag të nënshkrimit të marrëveshjes me këtë shoqëri për depozimin e mbetjeve në Z.T.M. Tiranë. Për sa më sipër po paraqesim për miratim në këshillin e bashkisë draft-marrëveshjen e lartpërmendur, e cila përmban dispozita në lidhje me:

1. Qëllimin e akt-marrëveshjes që është transportimi dhe depozitimi pranë Z.T.M.T, i mbetje të llojit urbane, duke respektuar afatet si edhe sasi të mbetjeve të deklaruara.
5. Detyrimet e bashkisë ku ndër të tjera përmendim si më kryesore :
 - detyrimin për të qënë e pajisur vete ose nepermjet nënkontraktoreve me licence të tipit III.2.B për transport të mbetjeve në destinacionin ZTMT, Tiranë.
 - detyrimin për të nënshkruar Aneksi IX të kontratës së koncesionit “Forma e Angazhimit mbi detyrimet e njësive vendore të Qarkut Durrës”.
 - detyrimin për njoftim në kohë në rast se do të ketë ndryshim të mjeteve transportuese, apo drejtuesve të këtyre mjeteve, duke deklaruar të dhënat e nevojshme identifikuese të mjeteve dhe drejtuesve të tyre.
 - detyrimin për respektimin e të gjitha procedurave dhe rregullave të shoqërisë Integrated Energy BV SPV shpk referuar mënyrës së depozitimit të mbetjeve, vendit të depozitimit .
 - detyrimin për caktimin e personit përgjegjes për të gjitha komunikimet referuar akt-marrëveshjes etj.
6. Kohëzgjatjen e akt-marrëveshjes, për një periudhë 5-vjeçare.
7. Pagesën dhe menyrën e kryerjes së saj, që konsiston në pagesën e tarifës si më poshtë: 29 Euro/ton pa TVSH, për depozitimin e mbetjeve të tipologjisë urbane, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit pasardhës.

Një kopje e akt-marrëveshjes i bashkëlidhet relacioni me qëllim njohjen edhe me dispozitat e tjera të parashikuara në të (akt-marrëveshje)

Juristi

Xhuana Keci

Sekretarja e Keshillit Bashkise

Kozeta Doda

Kryetari

Elton Arbana